



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/78

Datë: 09.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 73 dhe 74 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/78

Datë: 09.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e qëllimit të përdorimit të kompleksit banesor- afarist "Hade dhe Hade 2"

1. Kompleksit Kolektiv Banesor - Afarist "Hade dhe Hade 2" të ndërtuar nga mjetet e buxhetit të Republikës së Kosovës, në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1353/1,1353/2, 1354/3, 1356/1, 1358/1, Zona Kadastrale e Obiliqit, Komuna Obiliq, sipas projektit kryesor të miratuar me lejen ndërtimore Nr.04-351-432/2004 dt.05.11.2004 me përmbajtje prej 80 njësive banesore dhe 17 lokale afariste, i destinuar për qëllimin e kompensimit të paluajtshmërive të pronarëve privatë të shpronësuar për realizimin e projektit të dislokimit të fshatit Hade, KK Obiliq, i cili nuk është përdorur tërësisht sipas qëllimit të ndërtimit, I NDRYSHOHET qëllimi i përdorimit dhe shfrytëzimit të tij.
2. Nga hapësirat e kompleksit kolektiv Banesor - Afarist nga pika 1. e këtij vendimi, vetëm 3 (tre) njësi banesore dhe 1 (një) afariste është përdorur për qëllimin për të cilin është ndërtuar ky objekt, ndërsa hapësirat tjera nga ky objekt nuk janë shfrytëzuar për këtë qëllim, andaj të njëjtave iu destinohet qëllim i ri i përdorimit dhe atë:
 - 2.1. Pesëdhjetë (50)% të njësive banesore destinohen për qëllimin e zgjidhjes së banimit të familjeve, që janë raste sociale;
 - 2.2. Pesëdhjetë (50) % të njësive banesore për zgjidhjen e nevojave të banimit të kategorive të dala nga lufta e UÇK-ës - familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta nga këto kategori, dhe
 - 2.3. Sipërfaqet e hapësirave afariste të këtij kompleksi destinohen për hapësira administrative, si zyre për punësim, zyre për pensione apo për institucionet tjera shtetërore dhe organizata tjera joqeveritare.
3. Përzgjedhja e përfituesve të së drejtës së banimit nga pika dy (2), nënpika 2.1 dhe 2.2 të këtij vendimi do të bëhet sipas praktikave, rregullave dhe procedurave të parapara me Ligjin nr. 03/L-164, për Financimin e programeve të veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr. 21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta për banim, Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve

të veçanta të banimit, Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2010, për normat minimale të banimit për banesat nga programet e veçanta të banimit të nxjerra në bazë të këtij ligji, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.14/2014 për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për sigurimin e banimit familjar për familjet e dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-ës, për veteranët e UÇK-ës, invalidët civilë të luftës, viktimat seksuale të luftës dhe familjarëve të tyre.

4. Autorizohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të themelojë Komisionin përkatës për përzgjedhjen e përfituesve të drejtës së banimit në hapësirat sipas destinimit të përcaktuar në pikën dy (2) nënpika 2.1 dhe 2.2 të këtij vendimi. Në përbërjen e këtij Komisioni do të jetë së paku edhe një përfaqësues nga Komuna e Obiliqit.
5. Komisioni nga pika 4. e këtij vendimi, për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton Ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale.
6. Dhënia në shfrytëzim të hapësirave nga pika dy (2), nënpika 2.3 e këtij vendimi do të bëhet drejtpërdrejt me vendim të Ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale.
7. Njësive banesore dhe afariste nga ky kompleks, të cilat në mënyrë të ligjshme janë përdorur për qëllimin sipas të cilit është ndërtuar fillimisht kompleksi, nuk iu ndryshohet qëllimi i përdorimit me këtë vendim.
8. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komuna e Obiliqit për zbatimin e këtij vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/78

Datë: 09.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Obligohen të gjitha Institucionet Shtetërore dhe Publike, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, për përdorimin e Sistemit Elektronik të Shpronësimit të krijuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke futur të gjitha të dhënat e punës së tyre gjatë procesit të shpronësimit, vlerësimit, kompensimit dhe regjistrimit të pronave të paluajtshme.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Financave, institucionet tjera shtetërore dhe publike të cilat janë të involvuara në procesin e shpronësimit, të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/78

Datë: 09.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegrimit.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/78

Datë: 09.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 62.4 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-165, nr. 04/L-194 dhe nr. 05/L-063, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për miratimin e buxhetit për komunën e Zveçanit pas ri aprovimit të buxhetit për vitin 2016 nga Kuvendi Komunal i Zveçanit me datë 29 shkurt 2016.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Zveçanit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me tabelat t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/78

Datë: 09.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Vendimit të Qeverisë nr. 06/17 të datës 07.03.2015, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Republikës së Kosovës Nr. 06/17 të datës 07.03.2015

1. Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1.7 i Vendimit të Qeverisë nr.06/17 datë 07.03.2015 për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, si në vijim:
1.7. Rezak FETAI, Oda Ekonomike Gjermane.
2. Mandati i anëtarit të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar nga paragrafi 1. i këtij vendimi është 1 (një) vjeçar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/78

Datë: 09.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 200.000 (dyqind mijë) euro, për blerjen e skanerit "Teknologjia Valore Milimetrike" për nevoja të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nën programi "Shpenzimet e paparashikuara" me kod 13100 dhe barten në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nën programi Administrata e Kuvendit me kod 10200, kategoria ekonomike shpenzimet kapitale, projekti "Blerja e Skanerëve" me kod 14965.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë